

ARKIVA

Si u dekorua më 1917 Kolë Rrota me Kryqin e Artë të Kunorës nga Madhnija e Tij Perandori e Mbreti Karl për aktivitetin e tij si mësues e aktivist në Vjenë si dhe Koloninë Shqiptare në Zarë....

Pjeter Logoreci

Ndër ditët e tetorit 2010, kur unë isha i angazhuem me nxjerrjen e eshtnave të Imzot Nikollë Kacorrit, në Zentralfriedhof Vjenë (varrezën qendrore të Vjenës), u ndesha për herë të parë me disa dokumente, të cilat me ngjallën kureshtjen për të kërkuar ma shumë. Ndër regjistrat e inventarit të varrezës, gjindej dokumenti i pagesës së taksës së varrit të Imzot Kacorrit.

Sipas ligjit të vendit, në Austri, për çdo varrezë duhet detyrimi i qirasë së tokës pranë administratës së varrezave, përndryshe trualli i varrit u jepet i lirë në përdorim, me qira personave të tjerë për varrosje. Për 20 vjet, këtë detyrimin për varrezën e atdhetarit shqiptar dom Nikollë Kacorri e kishte pague (sipas dokumentave origjinal që gjinden në arkivën e varrezave të Vjenës), me datën 31 Maj 1917. Nikolaus Rotta, profesor i gjuhës shqipe në Vjenë, i cili kishte nënshkruar kontratën për të pague shumën mujore prej 100 Krone-sh. Ky akt i madh njerëzor e patriotik më nxiti të baj kërkime të matejshme për të gjetë se kush ishte Nikolaus Rotta e për ta njoftë ma mirë atë.

Prof. Nikolaus Rotta ose Kolë Rrota ishte djali i parë, i lindur në Shkodër në familjen me tradita qytetare e patriotike të Gjuhar Rrotës, me 22 Gusht 1880. Shtëpia atnore ku u lind Kola ndodhej asokohe në rrugicën e Gurakuqëve, mu përballë shpisë ku jetonte Luigj Gurakuqi, me të cilin Kola e dy vllaznit, kaluen fëmëininë e patën miqësi vllaznore. Gruja e Gjuharit, Marie Vjerdha, bijë e një familje të njohutun shkodrane, ndikoj shumë në edukimin patriotik të 3 vllaznëve. Kola ishte ma i madhi ndër tre vllaznit. Mbas Kolës erdhën në jetë Simoni e Ndoci (At Justinin), të cilët Gjuhari si burrë arsimdashës i shkolloi, duke e dërgue Kolën në fillim në Kolëgin Franceskan, e ma vonë në Kolëgin Jezuit të Shën Francesk Saverit. Simbas shënimeve që ka lanë nipi i tij, i ndjeri Rafael Rrota, Kola në fillim të shekullit të 20 dërgohet në Austri/Klagenfurt ku kryen studimet e larta. Vitet mbas studimeve e gjejnë Kolën mësues ndihmës të gjuhës shqipe në shkollën e Mati Logorecit në Prizren (1905) e ma vonë, me kërkesën e ministrisë së jashtme të Austrisë, punon mësues në mes arbëreshëve të Zarës (Dalmaci), ku kishte punue ma parë Pashk Bardhi dhe Ndue Paluca.

Nga viti 1913 Kola punon si ndihmës i Gjergj Pekmezit, i cili ishte asokohe këshilltar në ministrinë e jashtme të Austrisë për çështjet shqiptare, si dhe këshilltar e kujdestar i shqiptarëve që studionin në Austri ose që vinin për nevoja të ndryshme shëndetësore. Kola kishte kontakte të shumta me studiuesit gjermanishtfolës të gjuhës shqipe si M. Lambertz, A. Stotz, F. Manek. Ai ishte shumë aktiv në jetën politike, kulturore e sociale dhe bashkëpuntor i ngushtë i shoqërisë "Dija" që u krijue me 27 dhjetor të vitit 1904 në Vjenë nga Gjergj Pekmezi e Hilë Mosi. Kola shkruente në "Kalendarin e shoqërisë" nën inicialet K.R. Ai ishte mbledhës i apasionuem i folk-



Në detyrë

Në vjetin 1922 hapet konsullata e parë shqiptare në Vjenë e Kola emnohet Sekretar i Konsullates me Konsull Prof. Dr. Gjergj Pekmezin i cili qëndroi në këtë detyrë deri në vjetin 1924, kur u zëvendësue nga Konsulli i ri Dr. Nush Bushati. Aktiviteti i Kolës në Konsullate vazhdon deri me 1926. Pas një kthimi të shkurtër në Shqipëri, në 1928-të, Kolë Rota kthehet përsëri në Austri, por kësaj radhe me detyrën e Konsullit të Shqipërisë në Vjenë, si edhe tue u angazhuar me kujdesjen ndaj shqiptarëve që studionin e kuroheshin në Austri.

Në foto: Kolë Rrota me gruan e parë Marien dhe të birin e saj

andori e Mbreti Karl për aktivitetin e tij si mësues e aktivist në Vjenë si dhe Koloninë Shqiptare në Zarë.

Gazeta "Vllaznija" e Vjenës e datës 2 dhjetor 1917 shkruen me këtë rast: "Madhnija e Tij Perandori e Mbreti Karl e nderoj bashkëpuntorin t'one Professor Kolë Rrotën me Kryq t'arte të meritimit me Kunore. Jo vetëm tash në Vjenë si profesor i gjuhës shqipe n'institut të gjuhëve të lemit të Lindjes, por edhe ma përpara si mësues i Kolonisë Shqiptare n'Arbëreshë afër Zadre (Zara) ku u përpoq kurdoherë Rrota për të mirën e popullit të vet, qi e ka qaq

het përsëri në Austri, por kësaj rradhe me detyrën e Konsullit të Shqipërisë në Vjenë, si edhe tue u angazhuar me kujdesjen ndaj shqiptarëve që studionin e kuroheshin në Austri.

Me vdekjen e Prof. Dr. Gjergj Pekmezit në 1938-ten, Prof. Kola ngarkohet me drejtimin e katedrës së gjuhës shqipe në Institutin e gjuhëve Indogjermane në Universitetin e Vjenës deri sa del në pension mbas mbarimit të luftës së dytë botnore. Edhe mbas daljes në pension ai vazhdoi të ishte aktiv duke shkruar artikuj e studime mbi gjuhën shqipe. Kola ka mbajtur kontakte

Kolë Rrota

Zbulohet jeta e panjohur në Vjenë e patriotit shqiptar


Në vitet '60 në fund të jetës së tij, dërgonte letra për vëllezërit Simonin e at Justinin

lorit shqiptare duke mbledhë thanie të urta e fjalë të reja nga krahinat e ndryshme të Ballkanit ku banonin shqiptarë etnike. Në maj të vjetit 1913 përfundon në Borgo Erizzo librin e tij "Albanische Sprüche und Redensarten" me 800 fjalë të urta dhe

shprehje popullore shqipe të cilin e boton në Vjenë më 1914. Libri asht frut i një pune shumë vjeçare dhe ka 56 faqe në dy gjuhë, në shqip e gjermanisht. Në fund të vjetit 1917 Kolë Rrota dekorohet me Kryqin e Artë të Kunorës nga Madhnija e Tij Per-



Guri i varrit i Kolë Rrotës të cilin autori i këtij shkrimi e ka zbuluar pas shumë kërkimesh



Kopje e regjistrat nga varreza qendrore e Vjenës ku shënohet pagesa e taksës që Kolë Rrota ka bërë për varrin e Imzot Kacorrit (djathtas) Kopertina e librit që botoi Kolë Rrota në Vjenë më 1914-tën me shprehje e fjalë të urta shqipe



Në mes Gjergj Pekmezi, nga e majta e tij Anton Paluca, nga e djathta e tij në këmbë Kolë Rrota. Të tjerët nuk dihet me saktësi se kush janë, por mendohet se janë anëtarë të shoqërisë "Dija, ish-studentë në Vjenë

me familjen në Shkodër me anë të letërkëmbimit që nga vjetit 1960. Nipi i tij Rafael kam pasë letërkëmbim me axhën Kolë, tue fillue nga mesi i vitit 1960. Në atë periudhë, baba Simon nuk ishte në gjendje me i shkruar, prandaj në letrat qi unë i dërgojshë e vejshe në dijeni mbi ecurinë e smundjes së babës Simon, e ma vonë me 1964, për axhën, Pater Justinin. Në përgjigje të letrave më falenderonte gjithmonë e më porosiste qi mos me e harrue mbasi ishte në moshtë të madhe. Letra e fundit e axhës Kolë mban datën 10.02.1965, vetëm 5 ditë para se të vdiste".

Gjatë qëndrimit të përhershëm në Austri, Kola udhatoi vetëm 4 herë për në Shqipëri. Të parën herë në qeshor të 1905-sës për të vizitue familjarët mbas tërmetit katastrofal qi ra në Shkodër. Me 1929 e 1932 erdhni me shërbime në Tiranë si punonjës i ministrisë së jashtme, e të katërtën herë më 28 nandor 1937 i futem nga shteti shqiptar në funksionin e Konsullit në Austri, në kretimin e 25 vjetorit të shpalljes së Pamvarsisë së Shqipërisë.

Kola kje martue dy herë. Gruajja e parë Maria i vdes në vjetin 1940 e dëshprueme nga vdekja aksidentale e djalit të vetëm që e pat me burrin e parë. Ai kalon disa vjet në vetmi e vendosë të martohet për së dyti me Mari-anën (Maria), e cila ka vdeke 3 vjet mbas tij. Kola nga të dy martesat nuk ka pasë fëmijë. Ai vdes në Vjenë me 15 shkurt 1965 në moshën 85 vjeçare. E fshkurt dhe në vorrin e familjës së bashkëshortes Marie, në Grinzing, në Gruppin 8, Radhen 1, Numër 5.